



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 08.07..2013  
Nr. 0204-888

**PËR:** Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës  
Hazir Raçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës

**LËNDA:** KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË  
PODUJEVËS, Nr. 01/128 - 02, Pranuar me datë, 03.07.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 01/128 - 02 të miratuar me datë 27.06.2013 nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr. 01/128 - 02, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në Podujevë.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
**Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së**

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së  
Arkivit të MAPL-së



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datum: 08.07..2013  
br. 0204-888

**Za:** Agim Veliu, Gradonačelnik opštine Podujevo  
Hazir Raçi, Predsedavajući Skupštine opštine Podujevo

**Predmet:** Potvrda zakonitosti odluke opštine Podujevo , br. 01/128 - 02, primljeno  
dana , 03.07.2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br. 01/128 - 02, odobreno dana 27.06.2013, POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi, Zakon Br.04/L - 144 o davanju na korišćenje i razmeni neprokretnine imovine opštine.

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka 01/128 - 02, za određivanje lokacije o izgradnji Džamije u Podujevo.

Sa poštovanjem.

**Slobodan Petrović,**  
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopije:** Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a  
Rukovodiocima odeljenja MALS-a  
Arhivi MALS-a.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 14.1 dhe 17 shkronja s të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 19 shkronja s të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-1/298-10, dhe nenit 10 parag. 1.4 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr. 04/L-144, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2013, miratoi këtë:

### VENDIM

#### PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E XHAMISË NË PODUJEVË

##### Neni 1

Për ndërtimin e Xhamisë në Podujevë caktohet lokacioni i evidentuar sipas Certifikatës mbi të drejtat e Pronës së paluajtshme Nr.01183-10 pronë publike Komunale, kultura arë, vendi i quajtur "Podujevë" ngastra kadastrale nr.1183/10 në sipërfaqe prej 00,05.30 ha ZK Podujevë.

##### Neni 2

Kushtet teknike Urbanistike për ndërtimin e objektit-Xhami i cakton Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

##### Neni 3

Zbatimin e këtij vendimi e bëjnë Drejtoria për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe Drejtoria për Pronë Kadastër dhe gjeodezi.

##### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01/128-02  
Podujevë,  
27 qershor 2013



Kryesuesi i Kuvendit  
Hazir Raçi